

(24)



BASHKIA KORÇË



**AGJENCIA SHQIPTARE E
ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE**

MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI

NDËRMJET

AGJENCISË SHQIPTARE TË ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE

(AIDA)

DHE

BASHKISË KORÇË

"Për Programin e Përkujdesjes ndaj Investitorit & Promovimin e Investimeve"



BASHKIA KORÇË

Nr. 1507 prot., datë 21.02.2024



**AGJENCIA SHQIPTARE E
ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE**

Nr. 332 prot., datë 20.02.2024

MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI

Kjo marrëveshje mirëkuptimi (Marrëveshja) lidhet sot më datë __. __.2024 nga dhe midis:

Agjencia Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve (AIDA) krijuar me Ligjin Nr.10 303/2010 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve”, me adresë: Rr. Skerdilajd Llagami, Ndërtesa nr.1, Tiranë, përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv, **Znj. Laura Plaku (Saro)**, këtu e më poshtë referuar si AIDA,

dhe

Bashkia Korçë përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë **Z. Sotiraq Filo**, këtu e më poshtë referuar si Bashkia.

AIDA dhe Bashkia në vijim të këtij dokumenti do të quhen ‘Palë’.

Preambul

Një kuadër i favorshëm politikash për investimet e huaja direkte, si dhe një mjedis favorizues biznesi reflekton një klimë investimesh pozitive dhe mundësi më të mëdha për tërheqjen e investitorëve të rinj, duke e kthyer interesin e tyre potencial në projekte reale investimi. Shkalla e pjesëmarrjes së degëve të kompanive të huaja në ekonominë shqiptare dikton domosdoshmërinë për sigurimin e përkujdesjes ndaj investitorit.

Programi i Përkujdesjes ndaj Investitorit & Promovimi i Investimeve (këtu e më poshtë Shërbimi After-Care & Leads Generation), me mbështetjen dhe bashkëpunimin e qeverisjes vendore, ka krijuar dhe synon të përmirësojë zinxhirin e komunikimit midis aktorëve të ndryshëm rrelevantë, me qëllim përkrahjen e investimeve ekzistuese, nxitjen e ri-investimeve dhe promovimin e resurseve lokale/kombëtare.

Në kuadër të promovimit të investimeve, ruajtjes dhe inkurajimit të klimës së favorshme pro-biznesit;

Duke e konsideruar qeverisjen lokale si element kyç në mbështetjen e biznesit në nivel lokal;

Duke vlerësuar rëndësinë që ka promovimi dhe mbështetja e investimeve të reja në sektorët më të zhvilluar në nivel lokal;

Me dëshirën për të përmirësuar shërbimet me natyrë administrative ndaj bizneseve potenciale apo atyre ekzistuese;

Duke synuar krijimin e një mekanizmi eficient për zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave të hasura nga investitorët;

Duke afirmuar vullnetin dhe vendosmërinë për të bashkëpunuar dhe kontribuar në realizimin e kësaj marrëveshjeje;

Palët kanë vendosur të institucionalizojnë bashkëpunimin e tyre dhe bien dakord të lidhin këtë Marrëveshje Mirëkuptimi, me përfaqësim në nivel titullar institucioni, me parashikimet si vijon:

NENI 1

BAZA LIGJORE

Ligji Nr.10 303 datë 11.08.2010 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve”; Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; Ligji Nr.7764, datë 02.11.1993 “Për investimet e huaja”; Ligji Nr. 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore dhe nënligjore që kanë lidhje me fushën e investimeve dhe biznesit.

NENI 2

OBJEKTI DHE QËLLIMI

1. Objekti i kësaj marrëveshjeje është bashkëpunimi mes palëve për përmirësimin e klimës së biznesit si dhe rritja e koordinimit me qeverisjen lokale, në funksion të asistencës dhe mbështetjes ndaj investitorëve vendas dhe të huaj, duke krijuar një rrjet bashkëpunimi midis AIDA-s dhe Bashkive. Ky rrjet do të ketë si qëllim përkujdesjen ndaj investitorit (Shërbimi After-Care) dhe promovimin e investimeve (Leads Generation).
2. Palët kanë qëllim të ndërveprojnë me njëra - tjetrën në optikën e integritit të politikës së promovimit të investimeve vendase dhe të huaja në territorin shqiptar dhe të ofrojnë mbështetje operationale, administrative dhe strategjike për realizimin e projekteve lidhur me këto investime.
3. Palët angazhohen të zhvillojnë një politikë të përbashkët dhe të strukturuar për ofrimin e mbështetjes dhe lehtësive efektive në marrjen e shërbimeve, me qëllim dhënien e

një inputi për tërheqjen e investimeve dhe implementimin e tyre për periudha sa më afatgjata.

NENI 3

VEPRIMTARIA E AGJENCISË

1. AIDA, në funksion të veprimtarisë së saj kryen të gjitha veprimet dhe ndërmerr të gjitha nismat e nevojshme në mbështetje të zhvillimit të sektorit privat dhe të përmirësimit të klimës së biznesit dhe të investimeve në vend. Ajo shërben si një “One-Stop-Shop” duke ndjekur dhe ndihmuar subjektet tregtare private në të gjitha fazat e veprimtarisë së tyre ekonomike apo procesit të investimit.
2. AIDA në përmbajtje të tagrave të atribuara nga legjislacioni në fuqi, siguron qasje në informacione të përditësuara dhe luan një rol të rëndësishëm ndërmjetësimi dhe bashkëpunimi efikas midis investitorëve dhe organeve shtetërore, qendrore dhe vendore.
3. Kontributi dhe angazhimi i AIDA-s do të përqëndrohet kryesisht në:
 - a) lehtësimin dhe mbështetjen e investimeve të drejtpërdrejta në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet identifikimit dhe promovimit të mundësive për investime duke i ofruar shërbime mbështetëse dhe asistencë investitorëve potencialë dhe atyre ekzistues, vendas dhe të huaj;
 - b) rritjen e aftësisë konkurruese të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme që operojnë në Republikën e Shqipërisë;
 - c) promovimin dhe ofrimin e ndihmës për eksportet e mallrave dhe shërbimeve.

NENI 4

VEPRIMTARIA E BASHKISË

Në kuadër të kësaj Marrëveshjeje dhe në zbatim të funksioneve që ushtron, veprimtaria e Bashkisë me qëllim dhënien e suportit dhe asistencës së nevojshme për arritjen e objektivave dhe qëllimit të kësaj Marrëveshjeje për të cilat palët kanë rënë dakord, do të jetë e përqëndruar kryesisht në fushat:

- a) Të promovojë dhe vlerësojë zonat dhe infrastrukturën e përshtatshme për tërheqjen e investimeve dhe shërbimet publike që ofron;
- b) Të sigurimit të shërbimeve sociale;
- c) Të përforsimit dhe zhvillimit të ofertës kulturore në territorin shqiptar, sportit dhe shërbimeve argëtuese;
- d) Të garantojë mbrojtjen e mjedisit;
- e) Të zhvillimit dhe ruajtjes së bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit;
- f) Të zhvillimit ekonomik vendor;

- g) Të garantimit të sigurisë publike;
- h) Të promovimit të turizmit dhe vlerësimit të territorit;
- i) Të trajtojë me prioritet çështjet dhe problematikat e ndeshura që kanë lidhje me objektin e kësaj Marrëveshjeje;
- j) Të ndjekë me prioritet të gjitha procedurat organizative dhe operacionale për plotësimin e kërkesave infrastrukturore;
- k) T'i ofrojë asistencë të kualifikuar AIDA-s në mbledhjen dhe përgatitjen e informacionit të përditësuar dhe/ose dokumentacionit të nevojshëm mbi investime potenciale apo në zbatim;
- l) Të shqyrtojë me përparësi procedurat administrative për lëshimin e licencave, lejeve, autorizimeve në kompetencë të Bashkisë, të cilat mund të bëhen të kërkueshme për investimin/et sipas legjislacionit në fuqi.

NENI 5

MËNYRAT E BASHKËVEPRIMIT

“Përkujdesja ndaj investitorit/Shërbimi After-Care”

1. AIDA, në bashkëpunim me Bashkinë, në kuadër të programit After-Care do të hartojë një plan për metodologjinë e identifikimit, targetimit dhe numrin e kompanive që do të vizitohen. Palët do të rakordojnë nëpërmjet vendimeve të përbashkëta në lidhje me zhvillimin e takimeve periodike në kompanitë e përzgjedhura, duke marrë në konsideratë dhe vlerësuar sektorin/et e interesit, ndikimin që kanë në ekonominë e vendit, problematika të hasura sipas rastit gjatë zhvillimit të biznesit etj.
2. Çdo problematikë që i tejkalon kompetencat e pushtetit vendor do të ndiqet nga AIDA dhe do të adresohet me kujdes hap pas hapi drejt organeve përgjegjëse deri në zgjidhjen përfundimtare të saj.
3. Gjatë takimeve në qytete, përfaqësuesit e Bashkisë do të shoqërohen nga stafi i After-Care.
4. AIDA do të kujdeset vazhdimisht për përmbushjen me sukses të kërkesave të investitorëve të huaj, identifikimin e pronave përmes mbështetjes së bashkisë, mbështetjen në menaxhimin e projekteve gjatë gjithë ciklit të investimeve, si dhe ofrimin e shërbimeve aftercare të kategorizuar në administrative, operacionale dhe strategjike.

NENI 6

MËNYRAT E BASHKËVEPRIMIT

“Promovimi i investimeve/ Leads Generation”



1. AIDA do të asistojë stafin e Bashkive në promovimin e Shqipërisë si një destinacion për investime duke lehtësuar dhe mbështetur investimet direkte në Shqipëri (Leads Generation).
2. Në funksion të promovimit të Shqipërisë, si destinacion i investimeve të huaja, AIDA i ofron investitorëve lidhje me partnerët potenciale, të dhënat statistikore të detajuara dhe studime në lidhje me Shqipërinë dhe sektorët për promovim dhe prioritarë për të investuar.
3. Bashkia do të ofrojë mbështetje me anë të burimeve e kapaciteteve të saj dhe do të paraqesë pranë AIDA-s projekte potenciale investimi, projekt - ide/ projekt - fusha me qëllim promovimin e tyre tek investitorët e huaj.

NENI 7

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PËRBASHKËTA

1. Palët në funksion të veprimtarisë që kryejnë do të shkëmbejnë të dhëna të nevojshme në bazë të kërkesave zyrtare.
2. Palët angazhohen në një bashkëpunim dhe bashkërendim ndërmjet tyre për të zhvilluar një program të përbashkët sipas objektit të kësaj Marrëveshjeje me anë të bashkëpërdorimit dhe integritit të burimeve.
3. Palët do të bëjnë përpjekjet më të mira për të përshpejtuar dhe favorizuar proceset që kanë lidhje me zhvillimin e investimeve dhe të iniciativave të cilat do të sillnin rritje të punësimit dhe të faktorëve të tjerë ekonomik.
4. Palët marrin përsipër të bashkëpunojnë në kuadër të kësaj marrëveshjeje duke respektuar plotësisht legjislacionin e fushës dhe procedurat administrative.
5. Palët do të bashkëpunojnë në mënyrë aktive për të promovuar iniciativat e ndërmarra duke respektuar anagazhimet e parashikuara nga kjo Marrëveshjeje.
6. Palët marrin përsipër të përdorin mjetet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për thjeshtëzimin e aktivitetit administrativ si dhe përshpejtimin e procedurave vendimarrëse, kontrollit dhe ekzekutimit të ndërhyrjeve sipas kompetencave.
7. AIDA do të promovojë zgjidhjet dhe asistencën e ofruar nga Bashkia ndaj investitorëve në realizimin apo gjatë zbatimit të projekteve investuese, nëpërmjet kapaciteteve dhe burimeve të saj.

NENI 8

RUAJTJA E KONFIDENCIALITETIT

1. Palët marrin përsipër zbatimin me përpikmëri të detyrimeve ligjore të parashikuara mbi ruajtjen dhe mos-shpërdorimin e këtij informacioni konfidencial.
2. Shpërndarja dhe përdorimi i këtij informacioni për dhe nga palë të treta është i ndaluar dhe mund të lejohet vetëm me pëlqimin zyrtar të palëve.

NENI 9

MIRATIMI, HYRJA NË FUQI DHE NDRYSHIMET

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi pas nënshkrimit nga palët dhe është e vlefshme pa kufizim kohe deri sa palët të kërkojnë me shkrim shfuqizimin ose përfundimin e saj.
2. Marrëveshja hartohet dhe pranohet nga palët duke nënkuptuar se asnjë pjesë e tij nuk është në tejkalim ose në kundërshtim të dispozitave përkatëse ligjore, mbi të cilat palët mbështesin ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të tyre.
3. Asnjë ndryshim nuk mund t'i bëhet marrëveshjes në mënyrë të njëanshme. Palët kur gjykohet e arsyeshme mund të ndryshojnë ose të shtojnë dispozita të tjera në Marrëveshje, me shkrim dhe të miratuara me dakordësinë paraprake të të dyja palëve.

NENI 10

DISPOZITA TË FUNDIT

1. Palët angazhohen të zbatojnë Marrëveshjen për sa parashikohet në të.
2. Moszbatimi nga palët në mënyrë të përbashkët ose të njëanshme i ndonjë dispozite ose gjithë Marrëveshjes, nuk përbën shkak për mosmarrëveshje apo kusht që palët ti drejtohen gjykatës.
3. Palët duhet të bëjnë përpjekje që raste të tilla të mos ndodhin ose në rast të mosmarrëveshjeve që mund të lindin gjatë zbatimit të kësaj marrëveshjeje, të arrihet zgjidhje me mirëkuptim dhe nëpërmjet diskutimeve mes palëve nënshkruese. Në rast të kundërt, secila nga palët mund të tërhiqet dhe të ndërpresë në mënyrë të njëanshme Marrëveshjen, me njoftim paraprak prej 10 (dhjetë) ditësh.
4. Kjo marrëveshje bashkëpunimi hartohet në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet me vullnet të lirë nga palët pjesëmarrëse në 4 (katër) kopje origjinale, identike me njëra tjetrën, nga 2 (dy) kopje për secilën palë.

**PËR AGJENCINË SHQIPTARE TË
ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE**

DREJTOR EKZEKUTIV

LAURA PLAKU (SARO)



PËR BASHKINË KORÇË

KRYETARI

SOTIRIAQ FILO

